



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT NË FUSHËN E SIGURISË USHQIMORE,
VETERINARISË, MBROJTJES SË BIMËVE DHE PESHKIMIT**

Nr. 5899/1 prot.

Tiranë, më 03.08.2026

Lënda: Kthim përgjigje shkresës Nr. 4095 prot., datë 24.7.2026.

AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT

Tiranë

Në përgjigje të shkresës Suaj Nr. 4095 prot., datë 24.7.2026, protokolluar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me Nr. 5899, datë 27.7.2026, me lëndë “Kërkesë lidhur me procedurat në PIK për importin e mishit të gjedhit dhe mishit të shpendëve nga Brazili”, ku kërkohet marrja e masave me urdhër ministri lidhur me vijimin e procedurave pas datës 3 shtator për importin e mishit të gjedhit dhe mishit të shpendëve nga Brazili në Republikën e Shqipërisë, ju bëjmë me dije se:

Siç është cituar dhe në shkresën tuaj, Urdhëri i Ministrit Nr. 294, datë 13.6.2006 “Për importin e mishit nga Republika Federale e Brazilit” parashikon se importi në Republikën e Shqipërisë i mishit të gjedhit dhe mishit të shpendëve me origjinë nga Brazili, lejohet vetëm, në rastet kur këto produkte janë prodhuar në zona dhe stabilimente të miratuara nga Bashkimi Evropian dhe shoqërohen me certifikatën veterinare përkatëse.

Ndërkohë, me Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2026/1189, është ndryshuar Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2021/405 në lidhje me zbatimin e kufizimeve për përdorimin e disa produkteve antimikrobike mjekësore. Si rezultat i këtij ndryshimi, Brazili është hequr nga lista e vendeve të treta ose rajoneve të tyre të autorizuar për hyrjen në Bashkimin Evropian të dërgesave të disa kafshëve dhe produkteve me origjinë shtazore të destinuar për konsum njerëzor.

Në këto kushte, për sa kohë që Urdhri i Ministrit nr. 294, datë 13.06.2006, e kushtëzon importin me miratimin nga Bashkimi Evropian të zonave dhe stabilimenteve të prodhimit, ndryshimet e sjella me Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2026/1189 reflektohen drejtpërdrejt në zbatimin e këtij urdhri.

Për sa më lart, AKU të marri të gjitha masat e nevojshme për informimin e operatorëve të biznesit që importojnë mish gjedhi dhe mish shpendësh nga Brazili mbi ndryshimet e mësipërme, zbatimin e të cilave fillon nga data 3 shtator 2026, datë nga e cila fillon zbatimin e Rregullores Zbatuese e Komisionit (BE) 2026/1189.

Të informohet Ministria mbi masat e marra për zbatimin e sa më sipër.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

(Me zëvendësim të përkohshëm)

Eva Bica

